



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

A.A.nr.30/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Rustem Thaqi, anëtar të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët dhe Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.253/2025, të datës 01.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 06.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET e themeltë ankesa e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate (NISMA), Konservatorët dhe Intelektualët, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.253/2025, të datës 01.02.2025 dhe vendoset ashtu që: Refuzohet e pathemeltë ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë A.nr.253/2025, e datës 29.01.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.253/2025, të datës 01.02.2025, është vendosur: I. PRANOHET e bazuar ankesa e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.253/2025, e datës 29.01.2025. II. Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00 € (pesëmijë e pesëqind euro). III. Detyrohet Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualët, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualët, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, gjopa është shqiptuar përtej kapaciteteve të përcaktuara nga KQZ për Financimin e Subjekteve Politike dhe nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ndërsa vendimin

Anr.253/2025, të datës 01.02.2025, ta anuloj, ashtu që ankesën e subjektit “Lëvizja Vetëvendosje” ta refuzojë apo në rastin më të pavoritshëm ta ulë gjobën e shqiptuar, apo rastin të kthej në PZAP për rivendosje.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.253/2025, të datës 01.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet kandidati për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, z.Labinot Gjini, me datë 29.01.2025, ka të publikuar një postim në rrjetin social facebook në llogarinë e tij, duke përdorur gjuhë fyese dhe denigruese ndaj kandidatës për deputete Donika Gërvalla dhe Kryeministrit të vendit nga radhët e Lëvizjes VETVENDOSJE!, përmes titullit të postimit “BEOGRADI MENDON. DONIKA KALLZON”, pastaj “kjo grua që nuk e din sensin e fjalëve”, “kjo del nga një prodhim termash, qëndrimesh që burimin e ka në Beograd”, andaj thujse çdo fjali e postimit tjetër po qe se shkëputet, secila në vete përbën shkelje të nenit 34 par 1 nën par. 1.11 të LZP. Sipas parashtruesit të ankesës kandidati Labinot Gjini në paragrafin 3 në postimin e tij në rrjetin social facebook i paragjykon mendimet e znj. Donika Gërvalla duke parathënë diçka që kurrë nuk është deklaruar nga e njëjta siç është “e vetë quajtura ushtri çlirimtare”, “organizatë terroriste”, fjalë të thëna nga regjimi serb të cilat kandidati për deputet Labinot Gjini pretendon se këto fjalë mbështeten nga kandidatja për deputete Donika Gërvalla, ku në bazë të barrës së provës të njëjtin e bën përgjegjës të vërtetohet se qëndrimet e përmendura mbrohen nga kandidatja Donika Gërvalla. Me këtë parashtruesi i ankesës thekson se subjekti përkatës duke përdorur fjalor të rënduar në drejtim të ministres Gërvalla dhe Kryeministrit Kurti, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse duke shkaktuar një atmosferë të acaruar, nxitëse, shpifëse dhe ofenduese, andaj kërkon që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë ka bashkangjitur foton e postimit dhe linkun.

Me datë 31.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 31.01.2025 deri në ora 17:30.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 31.01.2025, subjekti politik Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, ka theksuar se i kundërshtojnë në tërësi pretendimet e subjektit politik LVV, duke i konsideruar ato të pabazuara. Në asnjë moment, z. Gjini nuk ka përdorur gjuhë që nxit dhunë ndaj znj. Gërvalla apo që promovon ndonjë formë urrejtjeje ndaj saj. Postimi i z. Gjini nuk përmbush elementet e dispozitës së përmendur, e cila ndalon gjuhën që nxit ose

provokon dhunë apo urrejtje. Përdorimi i fjalëve si “kjo grua nuk e din sensin e fjalës”, përbën kritikë dhe mos dakordësi politike, por nuk përmban mesazh që nxit dhunë kundër znj. Gërvalla apo pasurisë së saj. Po ashtu, asnjë nga shprehjet e tjera të përdorura nga z. Gjini në postimin të cilit i referohet ankuesi nuk përbëjnë gjuhë denigruese ndaj znj. Gërvalla, dhe shprehjet e tilla janë përdorur si simbolikë proteste dhe si formë e shprehjes së pakënaqësisë politike, pa pasur qëllim të provokojë apo nxisë veprime të dhunshme. Për më tepër duke qenë se dispozita në fjalë synon të parandalojë dhunën dhe urrejtjen, ajo nuk duhet të interpretohet në mënyrë që të kufizojë lirinë e shprehjes brenda kornizave të lejuara. Kritika dhe përdorimi i gjuhës simbolike janë veprime që bien brenda kornizave të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, kur nuk ka prova se ato kanë nxitur ose kanë potencial për të nxitur dhunë apo urrejtje. Andaj i propozojmë PZAP që pas shqyrtimit të kësaj përgjigje në ankesë të sjell Vendim me të cilin e refuzon ankesën e parashtruar nga subjekti politik LVV të identifikuar sipas shenjës A.nr.253/25 si tërësisht të pabazuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se ankesa është e bazuar, Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës e posaçërisht (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - fotot e postimit të ofruar si provë materiale, i cili është publikuar nga kandidati për deputet nga radhët e koalicionit AAK-NISMA Labinot Gjini, shihet se kandidati për deputete nga radhët e koalicionit AAK-NISMA ka shkaktuar atmosferë acaruese, nxitëse, shpifëse dhe ofenduese duke nxitur urrejtje ndaj subjekteve tjera politike në garë, në atë mënyrë që përderisa në postimin e tij ka bërë titullin “BEOGRADI MENDON, DONIKA KALLZON”, i cili postim ende është aktiv në llogarinë e tij në rrjetin social i postuar më datë 29 janar në ora 1:40 AM, paneli vlerëson se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Paneli vlerëson se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*. Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku në mënyrë decisive thuhet se *“subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00)euro”*.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën

dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kundër koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, nga neni 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, PZAP, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruar nga ankuesi dhe duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit të saj.

Duke vepruar sipas ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se pretendimet e ankuesit janë të qëndrueshme, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesën e subjektit politik ankues në PZAP, nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Gjykata pasi vlerësoj se pretendimet e subjektit ankues janë të qëndrueshme, vendimin e ndryshoj, për faktin se shprehjet e përshkruara në ankesën e subjektit ankues në PZAP, dhe të cituara në vendimin e atakuar, nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara sipas nenit 34 të LZP-së, sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate të njëjtat nuk ka karakter fyes, denigrues apo nxitës të urrejtjes ndaj subjektit politik LVV dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore. Një gjendje të tillë faktike gjykata nuk ka mundur ta vërtetoj as nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga dëshmia mbi postimin në rrjetin social facebook, të kandidatit për deputet Labinot Gjini.

Duhet theksuar se me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e*

domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.

Gjykata u ka kushtuar një vëmendje të veçantë fjalëve të përdorura në postimin e cituar sipas ankesës së ankuesit pranë PZAP-së, dhe kontekstit në të cilin është shprehur, dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, çmon se shprehjet e përdorura nuk përbëjnë shkelje të rregullave zgjedhore. Deklarimi është në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës, duke siguruar që liria e shprehjes është e mbrojtur, dhe nuk janë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore si dhe me praktikat ndërkombëtare dhe interpretimin e drejtësisë së lirisë së shprehjes, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së, që ka ndihmuar në formimin e qëndrimeve mbi balancimin e lirisë së shprehjes. Të njëjtat, nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve.

Për më tepër, neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshin: *“lirinë për të marrë e për të dhënë informacione ose ide në çdo gjuhë që mundëson pjesëmarrjen në shkëmbimin publik të informacioneve dhe të ideve të çfarëdollojshme kulturore, politike dhe shoqërore”.*

Ndërlidhur me këtë, theksohet kjo e drejtë është një nga shtyllat kryesore të një shoqërie demokratike dhe është thelbësore që të mbrohet gjatë fushatave zgjedhore. Megjithatë disa deklarata që janë bërë në kontekstin e fushatës zgjedhore mund të jenë të mbrojtura nga liria e shprehjes. Në përputhje me këtë, gjykata vlerëson se ndonëse, shprehjet mund të kenë qenë të ashpra, ato nuk përbënin fushatë nxitëse, veprime, apo fjalime për të ka nxitur ose provokuar, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, në rastin konkret ndaj kandidatës për deputete Donika Gërvalla.

Prandaj në këtë rast PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
AA.nr.30/2025, më datë 06.02.2025.

Kryetarja e kolegjit
Delushe Halimi